



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.2135, datë 19.07.2012

Për

“Shqyrtimin e Ankimimit administrativ të Albtelcom sh.a., ndaj Vendimit nr. 1975, datë 31.5.2012, të Këshillit Drejtues të AKEP, për “Miratimin e Ofertës Referencë të Aksesit në Rrjetin Lokal (RUO) të Albtelcom sh.a.””

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
4. Z. Benon	Paloka	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 19.07.2012, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999, “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shteterore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

Shqyrtimin e Ankimimit administrativ të Albtelcom sh.a., ndaj Vendimit nr. 1975, datë 31.5.2012, të Këshillit Drejtues të AKEP, për “Miratimin e Ofertës Referencë të Aksesit në Rrjetin Lokal (RUO) të Albtelcom sh.a.

BAZA LIGJORE:

1. Pika 1 e nenit 114 dhe pika 1 e nenit 115 të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (*Ligji nr. 9918*);
2. Neni 137, e vijues të Ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999, “Kodi i Procedurave Administrative” (K.Pr.A);
3. Rregullorja Nr.19 datë 14.06.2010 për “ Aksesin dhe Interkoneksionin”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP Nr.1300, datë 14.06.2010, i ndryshuar (*Rregullorja e Akses/Interkoneksionit*);
4. Pika 17, e nenit 21 të “Rregullores së Brendshme të AKEP (*Rregullorja e Brendshme*), miratuar me Vendim nr. 170, datë 24.04.2004 të Këshillit Drejtues të AKEP, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138, të Ligjit nr. 9918;
5. Vendimi i Këshillit Drejtues të AKEP, nr. 1565, datë 13.04. 2011, për “Përcaktimin e sipërmarrësit Albtelecom sh.a. me Fuqi të Ndjeshme në Treg dhe vendosjen e masave rregulluese në tregjet me shumicë të aksesit broadband (bitstream) dhe aksesit në infrastrukturën fizike (LLU)”;
6. Vendimi i Këshillit Drejtues të AKEP, nr. 1975, datë 31.5.2012, për “Miratimin e Ofertës Referencë të Aksesit në Rrjetin Lokal (RUO) të Albtelecom sh.a.”

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Shkresa e Albtelecom sh.a., me nr. 3276 Prot., datë 29.6.2012 (nr. 1363Prot. i AKEP, datë 2.7.2012) për “*Ndryshimin e pjesshëm dhe pezullimin e zbatimit të Vendimit të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 1975, datë 31.5.2012, për “Miratimin e Ofertës Referencë të Aksesit në Rrjetin Lokal (RUO) të Albtelecom sh.a., dhe pranimin e ankimit.”*”
2. Vendimi nr. 1975, datë 31.5.2012, të Këshillit Drejtues të AKEP, për “*Miratimin e Ofertës Referencë të Aksesit në Rrjetin Lokal (RUO) të Albtelecom sh.a.*”
3. Projektvendimin shqyrtimin e ankimimit administrativ të Albtelecom sh.a., ndaj Vendimit nr. 1975, datë 31.5.2012, të Këshillit Drejtues të AKEP, për “*Miratimin e Ofertës Referencë të Aksesit në Rrjetin Lokal (RUO) të Albtelecom sh.a.*”
4. Relacion shpjegues mbi Projekt-Vendimin (**Relacioni**);

si dhe duke i’u referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

- I. Albtelcom sh.a., në ankimin administrativ me nr. 3276 Prot., datë 29.6.2012, për “Ndryshimin e pjesshëm dhe pezullimin e zbatimit të Vendimit të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 1975, datë 31.5.2012, për “Miratimin e Ofertës Referencë të Aksesit në Rrjetin Lokal (RUO) të Albtelcom sh.a.””, parashtron si vijon:

Albtelcom në rastin e detyrimit për ofrimin e shërbimeve të aksesit LLU është angazhuar që të ofrojë në mënyrë proporcionale këtë shërbim, duke patur parasysh situatën konkrete të rrjetit Albtelcom dhe pritshmëri për transferimin në rrjetin NGN në të ardhmen e shkurtër. Albtelcom i është referuar praktikave më të mira të vëndeve të rajonit dhe më gjërë të praktikave më të mira ndërkombëtare në ofrimin e shërbimeve të aksesit (LLU).

Albtelcom ka pasu parasysh situatën e migrimit të infrastrukturës së tij fizike në rrjetin NGN si dhe mbrojtjen e konsumatorit për përfitimin maksimal nga ky migrim i rrjetit dhe jo shkaktim të pakënaqësive që mund të vijnë si pasojë e ndërhyrjes për migrimin e një linje fizike mbi të cilin tashmë është ofruar një nga shërbimet e aksesit LLU.

Albtelcom, kërkon që AKEP të pranojë propozimin fillestar të Albtelcom për mosdisponueshmërinë e ofrimit të shërbimit aty ku pika e lidhjes (SLCP) është planifikuar për t’u hequr brenda tre vjetëve.

Referencë:

Shtojca 1, e Skedarit të shërbimit 101, Përshkrimi i produktit të bashkëvendosjes fizike, pika 3 “disponueshmëria e shërbimit” fq. 35.

Shtojca 1, e skedarit të Shërbimit 104, Përshkrimi i produktit për aksesin në rrjetin lokal, pika 4 “mosdisponueshmëria e shërbimit” fq. 63.

Albtelcom sqaron se, siç ka informuar rregullisht AKEP, Albtelcom është në fazën e implementimit të projekteve të reja të cilët do të mundësojnë transformimin e rrjeteve të transmetimit, të komutimit dhe të aksesit në përputhje me teknologjite bashkëkohore që ofron tregu global.

Për rrjetin e aksesit projekti “NGN Project”, ka filluar në Korrik 2010 dhe përfundimi i tij është parashikuar në Dhjetor 2012. Nëpërmjet këtij projekti do të arrihet migrimi i të gjithë abonentëve (shërbimeve) që ofrohen aktualisht me teknologjinë TDM në atë NGN. Nga ecuria e deritanishme duket qartë që Albtelcom nuk do të mund të zëvendësojë plotësisht teknologjinë ekzistuese me atë të re brenda këtij viti për shkak të faktorëve objektivë si më poshtë:

- Vonesa e marrjes së lejeve të punës, nga Njësitë Vendore për instalimin e pajisjeve të reja në përputhje me projektin NGN si dhe kryerjen e punimeve civile të nevojshme për të mundësuar transferimin e abonentëve dhe shërbimeve në këtë rrjet të ri;
- Vonesa për frunizimin me energji elektrike të pajisjeve tona (*aktive*). Këto vonesa krijohen nga CEZ, për arsye të ndryshme si mungesa e kontaktorëve, pamundësi për instaluar pikën e lidhjes së energjisë elektrike etj.;

- Pengesa për kryerjen e punimeve të projektit, të krijuara nga qytetarët që nuk lejojnë kryerjen e punimeve edhe pse nuk janë në pronën e tyre private.

Për rrjetin e “Transmetimit backbone me fibër optike”, nuk mund të mbyllet punimet brenda 2012, sepse nuk është siguruar leja e punimeve nga Ministria e Punëve Publike dhe Transportit (DPRr) për segmentet Gjirokastër – Sarandë dhe Vlorë – Sarandë.

Albtelecom, sqaron se për kabinetet të cilët nuk mund të zëvendësohen gjatë 2012, por që patjetër do të zëvendësohen në të ardhmen, duhet që të mos konsiderohen pjesë e LLU, pasi praktikisht do të jetë e pamundur të ofrosh shërbim nëpërmjet tyre pas një periudhe të shkurtër kohore por jo brenda vitit 2012.

Referuar edhe ofertave referencë të aksesit për shërbimet të vendeve ku Albtelecom është mbështetur për draftimin e RUO-s, kanë parashikuar se ofrimi i shërbimit nuk do të ofrohet nëse pika e lidhjes (SLCP) parashikohet të hiqet nga puna brenda 3 vjetëve. Madje ky parashikim as që ka qenë i lidhur me ndonjë rrethanë specifike siç është Albtelecom për migrimin e rrjetit, çka e bën akoma më të detyrueshëm lënien në fuqi të një dispozite të tillë.

Albtelecom beson se kjo dispozitë është mbi të gjitha në favor të konsumatorit i cili do duhet të përballet me probleme si shkëputje e shërbimit nëse do të hiqet pika e lidhjes ose abonenti nuk do të mund të përfitojë nga cilësia e infrastrukturës së re të Albtelecom.

Albtelecom kërkon nga AKEP:

1. Pezullimin e afatit të zbatimit të Vendimit të Këshillit Drejtues të AKEP Nr. 1957 datë 31.5.2012 për “Miratimin e Ofertës Referencë të Aksesit në Rrjetin Lokal (RUO) të Albtelecom sh.a”
2. Ndryshimin e pjesshëm të Vendimit të Këshillit Drejtues të AKEP Nr. 1778 datë 20.12.2011 Nr.1975 datë 31.5.2012 për “Miratimin e Ofertës Referencë të Aksesit në Rrjetin Lokal (RUO) të Albtelecom sh.a” duke i kërkuar lënien në fuqi të dispozitës së propozuar të Albtelecom për mosdisponueshmërinë e ofrimit të shërbimit aty ku Pika e Lidhjes (SLCP) është planifikuar për tu hequr brënda 3 vjetëve.

- II. AKEP për sa i përket pretendimeve të ngritura në ankimin administrativ të sipërmarrësit Albtelecom sh.a., vlerëson se kërkesa e Albtelecom për ndryshimin e pikave të cituara në dokumentin e RUO të miratuar nga AKEP me VKD nr. 1975, datë 31.5.2012, nuk është e arsyeshme dhe e argumentuar. Albtelecom nuk ka dhënë asrye të justifikuara për ndryshimin e afatit për mosdhënie të shërbimeve në ambientet që do të hiqen brenda 3 viteve. Në bazë të përcaktimeve të RUO, Albtelecom ka detyrim t’i japë informacion operatorëve të tjerë për ambientet që parashikon të heqë brenda tre viteve të ardhshëm dhe është në zgjedhjen e operatorit dhe përdoruesit të Albtelecom që të marrin shërbimn e LLU për një afat më të shkurtër se tre vjecar. Në të tilla raste Albtelecom nuk ka detyrim ta ofrojë shërbimin përtej afatit të parashikuar për heqjen e ambientit të dhënë për LLU.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në pikën 1 të nenit 114, dhe pikën 1 të nenit 115, të ligjit nr. 9918, nenin 146, pika a, të K.Pr.A, si dhe pikën 17, të nenit 21 të Rregullores së Brendshme,

V E N D O S:

1. Rrëzimin e ankimit administrativ të Albtelecom sh.a. me nr. 3276 Prot., datë 29.6.2012 (nr. 1363Prot. i AKEP, datë 2.7.2012) për *“Ndryshimin e pjesshëm dhe pezullimin e zbatimit të Vendimit të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 1975, datë 31.5.2012, për “Miratimin e Ofertës Referencë të Aksesit në Rrjetin Lokal (RUO) të Albetelecom sh.a.”*”
2. Lënien në fuqi të Vendimit nr. 1975, datë 31.5.2012, për *“Miratimin e Ofertës Referencë të Aksesit në Rrjetin Lokal (RUO) të Albetelecom sh.a.”*
3. Të njoftohet Albtelecom sh.a. për zbatimin e këtij Vendimi;
4. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al

Ky Vendim hyn në fuqi datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARË:

1. Alban **KARAPICI**
2. Alketa **MUKAVELATI**
3. Benon **PALOKA**
4. Zamira **NURÇE**